

## STATUT

### I SHOQËRISE TREGTARE " FYBEK " SH.P.K.

#### K R E U     I

##### Neni 1

Shoqëria Tregtare " FYBEK " SH.P.K., është krijuar me Kontratën e dt.16.09.1976 në Tiranë, nga ortakët e saj Ethem Aliaj, Bardhyl Hazizi dhe Gjyshc Sherifi.

Statuti u përpilua nga ortakët të cilët në mbështetje të ligjës dhe akteve e tjera nënligjore vendosën, për të zhvilluar aktivitetet privat në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe për ta regjistruar në Gjykatë dhe organet financiare si një Person Juridik i lirë dhe i pavarur.

Kjo Shoqëri u krijua në bazë të investimeve të ortakëve, të cilët kanë edhe kompetencat e drejtimit administrativ dhe financiar të Shoqërisë.

##### Neni 2

Eshtë krijuar dhe do të regjistrohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë, organet financiare si dhe do të hapë llogari në vehte Shoqëria Tregtare " FYBEK " SH.P.K. në formën e Shoqërisë me tre ortakë.

##### Neni 3

Objekti i veprimtarisë së Shoqëria Tregtare " FYBEK " SH.P.K. do të jetë:

"Tregti me shumicë e biznes në të gjitha tushat dhe sektorët e lejuar nga ligji shqiptarë, turizëm dhe investime në këto sektor pune, brënda dhe jashtë vëndit."

##### Neni 4

Shoqëria Tregtare " FYBEK " SH.P.K. është person juridik, e drejtë kjo, që është fituar nga dita e regjistrimit të saj në gjykatë, dhe organin tatimor financiar.

Kjo Shoqëri gëzon të gjitha të drejtat që gëzojnë personat e tjerë juridik shqiptar dhe të huaj dhe garanton mbrojtjen e pasurive të saj, në përputhje të plotë me legjislacionin e vëndit, dhe lejimet e detyrimet e këtij Statuti.

Shoqëria u krijua për të ushtruar veprimtarinë e saj për një kohë zgjatje mbi 10 vjet.Ajo mund ta zgjasë afatin e

veprimtarisë ose ta mbyllë aktivitetin para këtij afati, sipas dispozitave e kriterëve ligjore.

## K R E U   I I

### Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 000 Lekë. Ky kapital themeltar zotërohet nga Ortakët në pjesë të barabarta me 1/3 secili. Kapitali themeltar, ose pjesë të caktuara të tij janë të transferueshme. Të gjitha veprimet e Shoqërisë mbi kapitalin themeltar bëhen nga tre ortakët.

### Neni 6

Zmadhimi ose zvoglimi i kapitalit themeltar në tërësi ose veçanti bëhet nga tre ortakët. Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen në një regjistër të veçantë.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit të saj, Shoqëria Tregtare " FYBEK " SH.P.K. krijon fondin rezervë, fondet e tjera financiare të veçanta për zhvillimin e saj, nxitjen ekonomike, grumbullimin e vulltës etj.

Përbërja, shuma e përgjithëshme, burimet e krijuarit të këtyre fondeve, përdorimi dhe rregullimi i tyre si dhe çdo aspekt tjetër që ka të bëjë me to, zgjidhen në bazë të ligjës dhe vullnetit të ortakëve.

### Neni 7

Detyrimet e Shoqërisë ,që do të lindin gjatë aktivitetit të saj me të tretët, mbulohen vetëm me pasurinë e saj. Ortakët që administrojnë pasurinë nuk përgjigjen për huatjet e kësaj Shoqërie me pasuritë e tyre që nuk janë futur në kapitalin e kësaj Shoqërije.

### Neni 8

Aktiviteti ekonomik i Shoqërisë pasqyrohet në bilancet financiare të cilat përpilohen tremujore dhe vjetore. Format e këtyre bilanceve si dhe afatet e mënyra e plotësimit të tyre caktohen nga Administratori Artan Asllani në përputhje me praktikën e personave të tjerë juridik të ngjashëm me të, si dhe udhëzimet e ligjet në fuqi.

### Neni 9

Fitimi neto i realizuar nga aktiviteti i Shoqërisë do të jetë pronë personale e tre ortakëve me nga 1/3 secili.

### Neni 10

Për veprimet me të tretët dhe ato me bankën Shoqëria Tregtare " FYBEK " SH.P.K. ka vullën me emërtimin përkatës. Kjo vullë përdoret nga Presidenti dhe administratori dhe vetëm mbi firmën e tyre gjë që do të depozitohet edhe në bankë.

## Neni 11

Stana e Shoqërisë do të përcaktohet më vonë dhe do të depozitohet në të gjitha organet e nevojshme.

### K R E U III

#### TE DREJTAT DHE DETYRAT E KESHILLIT TE ORTAKËVE

## Neni 12

Ortakët e Shoqërisë Tregtare " FYBEK " SH.P.K. kanë të drejtat dhe detyrat kryesore në Shoqëri, të cilat ushtronen nëpërmjet vendimeve të marra nga mbledhja e Këshillit të Ortakëve si :

- Administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë, në përputhje me Statutin dhe Kontratat përkatëse që do të lidhë kor të punëscisë ose aktivizojë avokatë ose nëpunës të tjerë.

- Realizimin dhe përfitimin nga rezultatet e çdo forme e sasi të veprimtarisë së Shoqërisë së parashikuar në Statutin dhe Kontratat përkatëse.

- Marrjen e informacionit të plotë për aktivitetin e Shoqërisë.

- Të interesohet dhe ushtoj kontroll për të kryer një aktivitet dëgjitoz nga çdo pjestar i Shoqërisë në përputhje me Ligjin për një funksionim sa më real të Shoqërisë dhe marrëdhënia sa më të mira të saj me klientët.

- Të respektoj ligjën, kontratën dhe statutin. Për çdo veprim të kundërt e të njëanshëm personi përgjegjës detyrohet ndaj Këshillit të Ortakëve, sipas parashikimeve ligjore e dokumentacionit të Shoqërisë.

- Të marrë pjesë në administrimin e Shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga ai vetë.

- Të kryej detyrimet e ngarkuara nga aktiviteti i Shoqërisë për realizimin e detyrave funksionale të saj.

- Bilancin vjetor të Shoqërisë.
- Shtimin ose pakësimin e ortakërisë.
- Bën modifikimin në STATUT sipas ecurive të Shoqërisë.

### K R E U IV

#### ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQËRISË.

## Neni 13

Organi më i lartë vendimor i Shoqërisë është KESHILLI I ORTAKËVE.

Administratori i Shoqërisë ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër dhe për llogari të Shoqërisë në marrëdhëniet me personat e tretë në konformitet me ligjin, Statutin dhe kontratat specifike. Për çdo veprim që bie ndesh me sa më sipër nuk përgjigjet Shoqëria. Në veprimet e kundraligjeshme dhe që nuk janë konform Statutit dhe Kontratës çdo ortak, administrator apo nëpunës i punësuar apo aprovuar si ortak rrezikon financiarisht vetëm pasurinë e vetë nga ai në emër të Shoqërisë, ose pasurinë personale.

Administratori duhet të kryejë vetëm ato detyra që nuk i janë lënë për kompetencë Keshillit të Ortakëve. Detyrat e kësaj të fundit mund të kryejë vetëm në rastet e parashikuara me ligj ose vendim të këtij Këshilli.

#### Neni 15

Vendosja e çmimeve është detyrë dhe e drejtë ekskluzive e Keshillit të Ortakëve. Çdo veprim i kundërt ka pasojat e shkeljeve financiare të parashikuara nga ligji.

#### Neni 16

Shoqëria i siguron klientët dhe punon në të sipas rregullave dhe kryesisht në mënyrë individuale, duke mos përjashtuar mundësitë që krijon hapja e Shoqërisë. Për aktivitetin jashtë shtetit kjo Shoqëri, nuk detyrohet të deklarojë fitimin. Ky deklaram është vetëm për aktivitetin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 17

Shoqëria Tregtare "FYBEK" SH.P.K. mban kontabilitet të rregullit dhe ka të drejtë të çeli llogari pranë bankave të vendit e të huaja në Shqipëri e jashtë saj dhe të kryejë veprimet e likuidimit nëpërmjet tyre si Shoqëri, si dhe të bëjë transferatë të kapitaleve të saj ndërmjet bankave sipas interesave të Shoqërisë.

#### Neni 18

Bilanci vjetor së bashku me deklaratën e të ardhurave të huasjerve e fitimeve, hartohet nga financieri, aprovohet nga Këshilli i Ortakëve dhe pastaj merr rrugën dhe fuqinë zyrtare.

#### Neni 19

Për punësimin dhe largimin e punëtorve, specialistëve dhe nëpunësve vepron në bazë të kontratës së punës. Në të janë evidentuar të drejtat dhe detyrat e punëdhënësit dhe punësuarit. Për problemet e marrëdhënieve të punës të paparashikuara nga kontrata zbatohen ligjet e punës.

## Neni 20

Shoqëria ka të drejtë të marrë kredi në lekë dhe valutë nga Banka e Shtetit Shqiptar ose nga bankat e tjera, shtetërore a private, vendase a të huaja për individët e saj ose për llogari të Shoqërisë.

Kjo Shoqëri ka gjithashtu të drejtë të vetfinancohet në lekë ose valutë të huaja.

Shkëmbimi i monedhës shqiptare me monedhë të huaj dhe anasjelltas bëhet nga përfaqësuesi i Shoqërisë në përputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose në tregun e lirë privat të valutave.

## K R E U V

### MBYLLJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE

## Neni 21

Veprimtaria e Shoqërisë pushon në rastet e parashikuara nga ligji. Mënyra dhe të drejtat e largimit për punonjësit e Shoqërisë, janë ato që janë përcaktuar në KONTRATE. Shoqëria mund të pushojë veprimtarinë e saj edhe para afatit të parashikuar në STATUT nëqoftëse vendoset në mbledhjen e Shoqërisë dhe miratohet nga Këshilli i Ortakëve.

## Neni 22

Kur Shoqëria pushon aktivitetin e saj, Administratori krijon komisionin e Likuidimit i cili paraqet bilanci e likuidimit. Këshilli i Ortakëve pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të ardhurave e disponon në funksion të detyrimeve dhe lejeve ligjore, si dhe të drejtave të pronësisë duke ruajtur masën 1/3 të çdo individi (ortaku).

## Neni 23

Pasuria që është futur në Shoqëri me të drejtë shfrytëzimi i kthehet pronarit të saj që sipas rastit mund të jetë dhe një person i tretë, sipas dokumentave përkatëse.

## Neni 24

Ky Statut u përcillua në mbështetje Aktave Ligjore e nënligjore shqiptare dhe hyn në fuqi menjëherë duke u dorëzuar sipas ligjës në Gjykatë, financë e bankë.

Selija e Shoqërisë do të jetë ajo në: L.ë Shkurti, Pallati 9 Ap.5, FIER.

Administrator i Shoqërisë do të jetë Z. Ethem Aliaj.